

Studenti i vlerësuar përsëritës ka të drejtë të riprovohet në sezonet e provimeve duke përfshirë si lëndët e vitit në vijim ashtu dhe ato të mbartura nga vite të mëparshme.

Studenti i vlerësuar përsëritës ka të drejtë të paraqitet në provim në vitin pasardhës, deri në dy herë për provimet e mbartura: një herë në njërin nga sezonet e provimeve sipas përkatësisë së lëndës që mbart dhe herën e dytë lejohet vetëm në sezonin e riprovimit.

#### **Neni 48**

##### **Afatet e provimeve**

Provimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik, të miratuar nga këshilli i fakultetit dhe kalendarit të provimeve që shpallet në fillim të vitit akademik. Ndryshimet e mundshme në kalendar bëhen të paktën një muaj para fillimit të sezonit të provimeve.

Datat e provimeve përcaktohen nga sekretaritetë mësimore në konsultim me departamentet dhe miratohen nga dekani.

Afatet e përcaktuara për provimet janë të detyrueshme për zbatim si për pedagogët, ashtu dhe për studentët.

Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde brenda një sezoni.

Studenti ka të drejtë të japë provim në të njëjtën ditë në lëndë të ndryshme, nëse e lejon orari i zhvillimit të provimeve, me kusht që të jetë regjistruar paraprakisht.

#### **Neni 49**

##### **Mënyra e zhvillimit të provimit**

Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Për shkaqe të forcës madhore apo shkaqe të tjera, dekani/drejtori urdhëron datën dhe orën e re të zhvillimit të provimit, duke njoftuar studentët të paktën 3 ditë para.

Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës, nga të cilët njëri duhet të jetë lektor i brendshëm. Komisioni përcaktohet nga titullari i lëndës i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit.

Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë.

Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Mënyra e sekretimit përcaktohet në rregulloret e brendshme të njësive kryesore.